

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Çfarë po ndërtojmë?" / Mevlan Shanaj thirrje publike Bulkut, Kabos e Becit: Po ju përdorin!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/fare-po-ndertojme-mevlan-shanaj-thirrje-publike-bulkut-kabos-e-becit-po--i584876
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 07:14:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 09:13:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9bd9d479e5eddfdb11a7c50d66541c1f3054f2b286ad1b55d89598e2ccd30a3d
TEKSTI	231b1f6229f0436b616441e3cfc34f4c1974ad3c4ba9fe151ad6d4f1e93d9bf8
PAMJA	7d18d360f270c5082c77f072c6ee0607d6d701f8114cfa197836ba266bf94480

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	70b24fb0a0302dcc6af6ee8c65eb7692600c0f2075d2ce6ba123988de0db242a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/70b24fb0a0302dcc6af6ee8c65eb7692600c0f2075d2ce6ba123988de0db242a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

1e Filmi shqiptar "AGJA" perzgjidhet ne Festivalin e VarshavesSHBA godet cisternat iraniane te naties: Irani bazat amerikane ne JordaniVendimi i veçantë i Federatës Spanjolle të Futbollit, futbollit fundit

“Çfarë po ndërtojmë?”/ Mevlan Shanaj thirrje publike Bulkut, Kabos e Becit: Po ju përdorin!

9 Shtator 2026, 11:13Kulturë TEMA



“Çfarë po ndërtojmë?”/ Mevlan Shanaj thirrje

Regjisori i njohur Mevlan Shanaji është drejtuar me një thirrje publike aktorese Rajmonda Bulku, profesor Përparim Kabos dhe producentit Petrit Becit, duke u kërkuar që të lexojnë mirë ligjin e ri të kinematografisë që është përgatitur për t’u miratuar në Parlament.

Shanaj paralajmëron se është krijuar një event si festivali i filmit që të shërbejë si paradhomë për ndryshimin e ligjit aktual të kinematografisë nga një grupim i lidhur ngushtë me këtë festival.

Sipas regjisorit, pas zhurmës së atij që ai e quan palo festival me 20 çmime karriere dhe 31 çmime të tjera, po përgatitet varrosja e filmit shqiptar me produksione të huaja.

“LIGJI I RI I KINEMATOGRAFISË – NJË TURP KU PO PERPIQEN TJU PERLYEJNE

Këto ditë po flitet për një festival të deformuar, i cili është krijuar të shërbejë si paradhomë për ndryshimin e ligjit aktual të kinematografisë nga një grupim i lidhur ngushtë me këtë festival. ju drejtohem juve :

Përparim Kabo, Raimonda Bulku, Petrit Beci, Esat Teliti, si persona të lidhur me filmin: lexojeni çorbën kundër filmit që po përgatitet dhe që rrezikon ta gëposë fare prodhimin e filmit shqiptar. Në projektin e ligjit të ri të kinematografisë, që po përgatitet këta që zhurmojnë me organizimin e këtij palo festivali, me 16 çmime karriere dhe 31 çmime festivali, me një Akademi pa autorësi të qartë, po përgatitet të futet në Parlament një ligj që, në vend që ta mbështesë, rrezikon ta varrosë prodhimin e filmit shqiptar.

Këtë e tutje do të zhduket edhe vetë koncepti “film”, ndërsa struktura do të quhet “Agjenci e Shërbimit Audiovizual”.

Aludimi është i qartë: shqiptarët do të vihen në shërbim të projekteve të huaja. Kuptoni: punonjës të dorës së fundit, sepse nuk ka grup të huaj që të vijë në Shqipëri dhe të marrë specialistët shqiptarë për nivelet kryesore të krijimit. Përveçse për punët që i duhen një produksioni të huaj në nivelin e fundit të hierarkisë.

A nuk është kjo një çmenduri? Përvojat kanë treguar se në disa filma të huaj që kanë trajtuar Shqipërinë, shqiptarët janë paraqitur përmes drogës, krimit, prostitucionit dhe figurës së burmëshës. Pra, pyetja është: çfarë po ndërtojmë? Një kinema shqiptare apo një servis shqiptar për produksionet e huaja?

Unë po ju drejtohem juve, sepse besoj se ju dhimbset filmi shqiptar po kaq sa mua.Apo jo, Beci?

Ti je ndër themeluesit e ligjit ekzistues. Prandaj pikërisht ty të drejtohem: lexoje mirë këtë projektligj dhe shiko se ku po shkon filmi shqiptar. Këta autorë anonimë që zhurmojnë nuk dihen kush janë, por kuptohet se kush po udhëheq këtë festival grotesk. Mos lejojmë që zhurma e festivalit të mbulojë atë që po përgatitet pas tij.

Sepse çështja nuk është më një festival. Çështja është nëse do të kemi apo jo prodhim shqiptar të filmit”, shkruan ai. A.K./TemA

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Filmi shqiptar “AGIA” përzgjidhet në Festivalin e Varshavës](#)

09:11 Kulturë

[92 mijë turistë vizitojnë Apoloninë](#)

16:45 Kulturë / 1 koment

[Gonxhja: Kullat e veriut në proces restaurimi dhe rijetësimi](#)

14:44 Kulturë

[Ilir Butka: Mungojnë fondet, promovimi dhe sallat për filmin](#)

12:40 Kulturë

[Tedi Papavrami në premierën e “The Bow and the Brush”](#)

10:42 Kulturë

[Mbyllet Festivali i komedisë “KokoFest”, “Babai” triumfon](#)

08:39 Kulturë

[The ghost in the text](#)

19:13 Kulturë / 1 koment

[Udhëtim me kompozimet e Haig Zacharian, Durrësi sjell “Muzikën e Filmave”](#)

17:11 Kulturë

[35-vjetori i rihapjes së Kryegjyshitës Bektashiane/ Fortlumturia Kryepeshkop Joani: Vlerat shpirtërore dhe bashkëpunimi ndërfaqet në shërbim të paqes dhe mirëkuptimit](#)

15:48 Kulturë / 4 komente

[Në Bylis nis ndërtimi i qendrës multifunktionale](#)

15:09 Kulturë

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...

14:15 Politika / 50 komente

Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, Filip Ça...

10:10 Sociale / 26 komente

FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...

17:35 Politika / 104 komente

Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...

14:50 Politika / 10 komente

Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...

19:40 Politika / 104 komente

Blog Tema

“Respekte”, z. Korrupsion!

22:30 Blog / 6 komente

Përse dështoi Reforma në Drejtësi

17:10 Blog / 36 komente

Pelegrinazhi amerikan i Berishës i duhet vetëm Berishës

16:24 Blog

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.